



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 14 regjistër (JR)
Datë 09.03.2022

Nr. 24 i vendimit
Datë 25.03.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, ditën e martë, më datë 25.03.2025, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 14/2022 (JR), datë 09.03.2022, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit Ermira Dedja, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 496, datë 12.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ermira Dedja.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijuese të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e ngritura në ankim dhe parashtrimet nga subjekti i rivlerësimit, e cila kërkoi gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, shqyrtimin në themel të fakteve, administrimin e provave të reja, ndryshimin e vendimit nr. 496, datë 12.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, dhe e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ermira Dedja, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Duke qenë se ushtronte këtë funksion, ajo u përfshi në rrethin e subjekteve që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit nga Komisioni.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi deklaratat dhe formularët e dorëzuar nga subjekti dhe raportet e hartuara nga organet ndihmëse, deklaratën e pasurisë *vetting*, dorëzuar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”), sipas të cilave:
 - 2.1. ILDKPKI-ja¹, në zbatim të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:
 - deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
 - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja² ka informuar për Komisionin se në ngarkim të subjektit Ermira Dedja nuk disponohen të dhëna.
 - 2.3. KLGJ-ja³ ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

¹ ILDKPKI, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.09.2021; shkresat nr. {***} prot., datë 17.08.2021 dhe nr. {***} prot., datë 16.07.2021, ka përcjellë në Komisionin informacionin e përditësuar nga organet ndihmëse.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.12.2017, e deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. {***}, datë 28.12.2020.

³ Raporti i KLGJ-së nr. {***} prot., datë 09.03.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Pas kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar për të tria kriteret, me vendimin nr. 496, datë 12.01.2022, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratime të pasakta, që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës së rivlerësimit. Për këto arsye, Komisioni vlerësoi që subjekti ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni e mbështeti analizën në konkluzionet e mëposhtme:

3.1. Për apartamentin e banimit, me vlerë 4.680.000 lekë, në Shkodër, subjekti i rivlerësimit:

(i) Ka kryer deklaratim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën *vetting*, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë “apartament”, në kundërshtim me parashikimin e gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

(ii) Ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 1.518.666 lekë, për pagimin e këstit të parë, në mars të vitit 2009, duke u gjendur në kushtet e gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit 84/2016.

(iii) Ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 1.798.672 lekë, për pagimin e këstit të dytë, në mars të vitit 2010, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga germa “b” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3.2. Për automjetin tip “Volkswagen”, të blerë në vlerën 250.000 lekë, subjekti i rivlerësimit:

(i) Ka kryer deklaratim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën *vetting* të vitit 2017, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë “automjet” tip “Volkswagen Golf”, në kundërshtim me parashikimin e gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

(ii) Ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 590.589 lekë, në datën 23.03.2007, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

(iii) Ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 252.031 lekë për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2016, duke u gjendur në kushtet e gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Me vendimin e Komisionit, nuk është dakord subjekti i rivlerësimit, e cila ka ushtruar ankim në Kolegj. Nëpërmjet ankimit, subjekti ngre pretendime që lidhen me procesin e rregullt ligjor, kundërshton vlerësimin e Komisionit lidhur me kriterin e pasurisë, ashtu sikurse edhe atë profesional. Subjekti kërkon, ndër të tjera, edhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve. Shkaqet e ankimit paraqiten si vijon:

4.1. Për procesin e rregullt ligjor

(i) Subjekti pretendon se është cenuar procesi i rregullt ligjor për shkak se, bazuar në të njëjtat fakte të analizuar nga ILDKPKI-ja, vendimi i Komisionit arrin në një konkluzion të ndryshëm.

(ii) Subjekti pretendon se Komisioni zbatoi në mënyrë të gabuar në rastin e saj, pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjvënësit, për të larguar nga sistemi i drejtësisë personat që janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme dhe si pasojë e kësaj veprimtarie kanë krijuar pasuri.

(iii) Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit, pasi në raste të ngjashme ka arsyetuar ndryshe, sa i takon pasaktësisë së deklaramëve⁴.

4.2. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

(a) *Apartamenti me sipërfaqe 104 m², me vlerë 4.680.000 lekë, në Shkodër:*

(i) *Për mosdeklarimin e porosisë në deklaratën periodike për vitin 2008*, subjekti pretendon se nuk e posedonte apartamentin në vitin 2008 dhe nuk kishte hyrë në marrëdhënie juridike me investitorin, për rrjedhojë, nuk kishte objekt deklarimi. Lidhja e kontratës me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim OSHEE) është bërë me konsensus për çdo banor, në tetor të vitit 2008, por nga konsumi vërehet se nuk kanë banuar në atë apartament deri në mars të vitit 2009. Qëndrimi i Komisionit është i paqartë, sipas subjektit, pasi nuk kuptohet cila është shkelja e saj, në një kohë që nuk kishte objekt deklarimi⁵.

(ii) *Për mosdeklarimin e detyrimit të mbetur në deklaratat periodike 2010, 2011, 2012 dhe 2013*, subjekti pretendon në ankim se, duke deklaruar vlerën totale të pasurisë, sikurse edhe vlerën e kësteve që shleu në vitet 2009 – 2010, automatikisht kuptohej që detyrimi i mbetur ishte 500.000 lekë. Subjekti shpjegon se pas informimit nga ILDKPKI-ja, ajo e deklaroi detyrimin në deklaratat në vijim. Përpos kësaj, subjekti pretendon se në deklaratën *vetting*, e cila është objekt i kontrollit të organeve të rivlerësimit, e ka deklaruar saktësisht detyrimin e mbartur, ashtu sikurse në deklaratat pasardhëse nisur nga ajo e vitit 2014.

(iii) *Për mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë*, subjekti shpjegon se si burim i krijimit të pasurisë/shlyerjes së kësteve shërbyen të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti si arkitekt/inxhinier projektues. Mënyra se si ajo e ka kuptuar deklaratën ishte e tillë, që duke deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të saj, i regjistruar si person fizik inxhinier projektues, e ezauroi detyrimin e deklarimit të burimit të krijimit të pasurisë, duke përmbushur kështu jo vetëm detyrimin e deklarimit, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave për mundësinë e shlyerjes së kësteve.

(iv) *Për burimin e shlyerjes së kësteve të apartamentit*, subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar në vlerësim, pasi ajo i deklaroi të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit që mundësuan

⁴ Subjekti referon vendimin e Komisionit nr. 46/2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori.

⁵ Subjekti referon vendimin e Kolegjit nr. 35/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Arqile Koça, paragrafi 25. Në këtë vendim, Kolegji ka arsyetuar: “Mosdeklarimi i marrjes në dorëzim të tetë pasurive të paluajtshme në vitin 2009 (pa fituar ende titullin e pronësisë mbi to), në vlerësim të trupit gjykues, nuk përbën shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, germa “a”, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, mbi deklarimin e pasurive të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë titulli i pronësisë së këtyre sendeve të paluajtshme ende nuk kishte kaluar te subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues konstatoi se, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni në vendim, detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim dhe zotërim të subjekteve rivlerësuese është përcaktuar në mënyrë të shprehur për herë të parë në legjislacionin e posaçëm, që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016. [...]”.

shlyerjen e kësteve me të ardhura të ligjshme. Fakti që subjekti ka deklaruar të ardhurat, tregon që i dispononte dhe ishin pjesë e arkës së personit fizik.

(iv/a) Për këstin e parë, në vlerën 2.180.000 lekë, shlyer në mars 2009, subjekti kundërshton analizën e Komisionit, që ishte përllogaritje proporcionale vjetore e të ardhurave, të tremujorit të parë të vitit 2009. Natyra e aktivitetit të bashkëshortit ishte e tillë, që nuk mund të pjesëtohet fitimi total në çdo tremujor në pjesë të barabarta, por duhet të përllogaritet sipas të ardhurave të çdo projekti të porositur. Ky këst u likuidua nga të ardhurat e bashkëshortit nga viti 2008, të cilat iu vunë në dispozicion familjes pas pagimit të tatimit, në muajin mars të vitit 2009, dhe subjekti nuk ishte në dijeni të fitimit të vitit 2008, për ta deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse.

(iv/b) Për pagimin e këstit të dytë, në vlerën 2 milionë lekë, në datën 29.03.2010, ashtu si për këstin e parë, subjekti kundërshton mënyrën përpjesëtimore të llogaritjes së të ardhurave të bashkëshortit. Sipas subjektit, edhe për këtë këst kanë përdorur të ardhurat e vitit 2009. Shlyerja në muajin mars të secilit vit është bërë pikërisht për arsye se në këtë moment janë përllogaritur fitimet dhe paguar detyrimet tatimore të personit fizik.

(iv/c) Subjekti pretendon se metoda e përdorur nga Komisioni, duke mos marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara nga viti paraardhës, është penalizuese. Sipas saj, nëse kryhet një vlerësim duke marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme të vitit paraardhës, ajo dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi që të krijojnë pasurinë.

(b) Për automjetin “Volkswagen Golf”, me vlerë 250.000 lekë, subjekti shpjegon se si burim shërbeu depozita e bashkëshortit, e krijuar në vitin 2006. Me qëllim që të mos humbin interesat vjetorë, bashkëshorti i mori hua vëllait të subjektit dhe ia ktheu brenda vitit, pasi tërhoqi depozitën. Vëllai i saj ka pasur mundësi për dhënien e huas dhe dokumentacioni provues duhet të ishte pranuar nga Komisioni. Gabimet e paqëllimshme në deklaratat periodike nuk mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi në kuadër të procesit të rivlerësimit.

4.3. Për analizën financiare

(i) Për shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortit në Turqi, në vitin 2010, subjekti pretendon se Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë deklaratën e z. Xh. B., i cili ka konfirmuar se ka përballuar shpenzimet e bashkëshortit të saj, sepse kishin marrëdhënie pune, për shkak të të cilave u krye edhe udhëtimi.

(ii) Për balancën negative prej 252.031 lekësh, në vitin 2016

(ii/a) Sipas subjektit, ajo është pasojë e ndihmesës ekonomike modeste, të cilën fëmijët e morën nga gjyshërit për përballimin e shpenzimeve të jetesës, që justifikon edhe mungesën e konstatuar.

(ii/b) Subjekti kërkon që analiza financiare të kryhet duke zbatuar parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit. Ajo nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve; nuk ka bërë deklaram të rremë; nuk ka bërë fshehje pasurie; si dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Për rrjedhojë, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në rastin e saj nuk gjen zbatim.

(iii) Mosdeklarimi i llogarisë në Tirana Bank ka ndodhur për shkak të lodhjes dhe ngarkesës në punë. Ajo deklaroi të ardhurat nga paga, dhe kjo llogari ishte pikërisht llogaria e pagës dhe nuk mund të përdoret si shkak për masën disiplinore.

4.4. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, pavarësisht se në konkluzion Komisioni nuk e ngarkoi subjektin me përgjegjësi, duke e kualifikuar si të aftë, subjekti ka parashtruar se:

(i) Konkluzioni i Komisionit në vendim, kur vlerësoi se subjekti është “e aftë” në këtë kriter, në mënyrë të qëllimshme krijoi konfuzion lidhur me denoncimin e pretenduar nga z. G. Y. Sipas subjektit, ndryshimi i konstatimit të Komisionit nga “denoncim” në rezultatet e hetimit, në “burime të tjera” në vendim, nuk u arsyetua përse ndodhi.

(ii) Subjekti potencon se pranoi kërkesën për përjashtimin e një gjyqtareje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi në seancë gjyqtarja në fjalë kishte shprehur mendim në dukje paragjykes ndaj procesit. Për kërkesën e paraqitur nga i njëjti person, ndaj së njëjtës gjyqtare, në rastin tjetër, nuk u evidentuan elemente që të përligjinin pranimin e kërkesës. Si rrjedhojë, nuk ka mbajtur qëndrime të ndryshme, por zbatoi testin objektiv dhe subjektiv, nëpërmjet një analize të detajuar të të dhënave dhe të kuadrit faktik, juridik dhe institucional të gjykatës, qëndrime të cilat nuk u ankimuan nga palët.

4.5. Në datën 17.03.2025, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj edhe parashtrimet e saj me shkrim. Në këtë akt, subjekti i qëndron shkaqeve të ankimit dhe kërkon pranimin si provë e re edhe të dy deklaratave noteriale që ka paraqitur, duke kërkuar përfundimisht që çështja të gjykohet në seancë publike me praninë e saj. Për themelin e çështjes, subjekti kërkon trajtimin e saj në mënyrë proporcionale, pasi deklarimi ka qenë në përputhje me ligjin dhe ka pasur mundësi që të krijonte pasuritë me të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit. Vendimi i Komisionit ishte i njëanshëm dhe i paragjykuar, i pabazuar në hetim të kryqëzuar të provave, por vetëm mbi gjetje, duke sjellë cenim të drejtpërdrejtë të mbrojtjes së subjektit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykes të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

6. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegj

7. Vendimi objekt shqyrtimi është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe, si rregull, gjykimi i çështjes në Kolegj zhvillohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh. Përjashtimisht, çështja mund të gjykohet në seancë gjyqësore (publike) në përputhje me nenin 51⁶ të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), kur Kolegji konstaton se: (a) duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja për konstatimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike; (b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; dhe (c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë.

7.1. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti ka bashkëlidhur disa akte të reja, të paparaqitura më parë në Komision. Nëpërmjet tyre, subjekti kërkon të provojë të ardhurat e bashkëshortit të saj të ndërë dhe pamundësinë e paraqitjes, në kuptim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, edhe me parashtrimet në datën 17.03.2025, në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dy akte të reja, deklarata noteriale⁷. Nëpërmjet tyre, subjekti kërkon të provojë pamundësinë e sigurimit të dokumentacionit për të provuar disa nga të ardhurat e bashkëshortit dhe për mbulimin e shpenzimeve të pushimeve të bashkëshortit në Turqi.

7.2. Aktet bashkëlidhur ankimit janë si vijon:

- (i) Vërtetim i njësisë me origjinalin, datë 01.03.2022, “Bllok Faturë e thjeshtë tatimore”, lëshuar më datë 20.05.2008, në favor të z. A. D⁸. (*modeli/seria 04*).
- (ii) Vërtetim i njësisë me origjinalin, datë 28.02.2022, “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 09.04.2009, me shitës z. A. D.”; Veprim arke me referencë {***}; Kërkesë për transferim fondesh, datë 10.04.2009; Nxjerrje llogarie, datë printimi 04.05.2009, për shoqërinë “{***}”.
- (iii) Vërtetim i njësisë me origjinalin, datë 28.02.2022, “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 07.05.2009, me shitës z. A. D.”; Veprim arke; Kërkesë për transferim fondesh, datë 01.05.2009; Ditar llogarie, me datë printimi 04.07.2009, për shoqërinë “{***}”; Nxjerrje llogarie, datë printimi 01.07.2009, për shoqërinë “{***}”.
- (iv) Vërtetim i njësisë me origjinalin, datë 28.02.2022, “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 07.05.2008, me shitës z. A. D.”; Veprim arke me nr. reference {***}; Kërkesë për transferim fondesh, datë 13.07.2009; Nxjerrje llogarie, me datë printimi 31.07.2009, për shoqërinë “{***}”.
- (v) Vërtetim i njësisë me origjinalin, datë 01.03.2022, “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 30.01.2009 me shitës z. A. D.”; “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 01.07.2008”; “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 20.06.2008”; “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 12.06.2008”; “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 04.06.2008”; “Faturë e thjeshtë

⁶ I cili zbatohet nëpërmjet pikës 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

⁷ Deklarata noteriale nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 08.03.2025, nga një person që shprehet se ka përfituar shërbime nga bashkëshorti i subjektit, në shtator 2008, dhe deklarata noteriale nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 16.03.2025. lëshuar nga M. Gj., ish-qiradhënës i ambientit ku bashkëshorti i subjektit kishte aktivitetin privat.

⁸ Bashkëshorti i ndërë i subjektit të rivlerësimit.

tatimore nr. {***}, datë 28.05.2008”; “Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 21.05.2008”;
“Faturë e thjeshtë tatimore nr. {***}, datë 15.09.2008, me shitës z. A. D.”.

- (vi) Pasqyrë e llogarisë në euro, të klientit z. A. D., printuar më datë 03.01.2022, nga Raiffeisen Bank ShA, Dega Shkodër.
- (vii) Nxjerrje llogarie e klientit “{***}” ShPK nga Union Bank ShA, vulosur më datë 01.03.2022.
- (viii) Statement bankar i shoqërisë “{***}” ShPK, nxjerrë nga Intesa Sanpaolo Bank ShA, Dega Shkodër.
- (ix) Shkresa datë 01.03.2022, e Intesa Sanpaolo Bank, bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit.
- (x) Shkresë “Mandato di assistenza e rappresentanza”, datë 14.02.2022, lëshuar nga subjekti “{***}”, i përkthyer, i vërtetuar përkthimi i përkthyeses të licencuar, për të ardhurat e vëllait të subjektit.
- (xi) Projekt dhe leje për ndërtimin e godinës së z. Xh. B., me arkitekt bashkëshortin e subjektit – përgjigjja nga Bashkia Shkodër.

7.3. Në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti ka detyrimin që të provojë se, pa fajin e saj, nuk ka mundur t’i paraqesë këto akte në Komision. Subjekti parashton se, për shkak të kohës së shkurtër nga seanca dëgjimore, deri në shpalljen e vendimit të Komisionit, nuk arriti të paraqiste akte të tjera për të provuar *gjendjen e arkës* apo disponimin e të ardhurave në fund të vitit nga aktiviteti i bashkëshortit si inxhinier projektues/arkitekt. Gjatë shpjegimeve në Komision, subjekti ka pretenduar se të ardhurat që ka gjeneruar bashkëshorti i saj i ndjerë nga shërbimet që ai ofronte si arkitekt, në qytetin e Shkodrës, shërbyen për krijimin e apartamentit të banimit, objekt kontrolli në proces.

7.4. Konkretisht, me aktet e pasqyruara në pikat “i” – “v”, subjekti ka depozituar fatura të thjeshta tatimore për aktivitetin e bashkëshortit, për periudhën 2008 – 2010, për të provuar të ardhurat e bashkëshortit; aktet e pasqyruara në pikat “vi” – “ix”, janë nxjerrje të llogarive të bashkëshortit të saj, apo të firmave që kanë kryer transferta të vlerave monetare në llogari të tij. Nëpërmjet shkresës së numërtuar “x” në listë, subjekti kërkon të provojë mundësinë financiare të vëllait të saj për të dhënë huan me të cilën bashkëshorti bleu automjetin “Volkswagen Golf”. Së fundmi, me shkresën e Bashkisë Shkodër, numërtuar “xi”, që pasqyron projektin dhe lejen e ndërtimit të godinës me investitor z. Xh. B. dhe arkitekt bashkëshorti i subjektit, subjekti kërkon të provojë ekzistencën e marrëdhënies së bashkëshortit me z. B., që financoi shpenzimet e udhëtimit të tij në Turqi, në datat 18 – 21 nëntor 2010.

7.5. Nga analiza e sa rezulton prej këtyre akteve dhe atyre në fashikujt e Komisionit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se, ndonëse disa prej akteve të sjella nga subjekti duket se datojnë pas dhënies së vendimit, e konkretisht 12 janar 2022, në kushtet që subjekti u njoh, që në 3 dhjetor 2021, me rezultatet e hetimit, fakti që mes seancës dëgjimore dhe asaj të shpalljes së vendimit, gjatë të cilës Komisioni i ka kërkuar të sjellë edhe akte të tjera, kanë kaluar vetëm dy ditë, merr rëndësi dytësore. E thënë ndryshe, pavarësisht se është e vërtetë që udhëzimi i Komisionit për të sjellë akte shtesë, në thelb, ishte i pamundur të zbatohet, pasi flitej vetëm për 48 orë (mes datës 10 dhe 12 janar 2022), subjekti i rivlerësimit ishte

në dijëni, më së paku⁹, që në fillim të dhjetorit për faktin që aktet e sjella prej saj ishin të pamjaftueshme për të provuar të ardhurat e pretenduara të gjeneruara nga aktiviteti i bashkëshortit për periudhën në të cilën është porositur dhe janë shlyer dy këstet e para¹⁰ të apartamentit në Shkodër (datë 29.03.2009 dhe 20.03.2010). Për pasojë, udhëzimi në seancë paraqet rëndësi të papërfillshme, pasi çfarë nevojitej i ishte bërë me dije subjektit që më parë.

7.6. Së dyti, edhe duke abstraguar nga sa konstatohet më sipër dhe nga fakti që disa prej akteve paradatojnë vendimin e Komisionit, në analizën e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit, nën dritën e nenit 49, pika 6, geramat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, vlera provuese e tyre mbetet e kufizuar, pasi ato përbëjnë fatura të thjeshta tatimore të shërbimeve të bashkëshortit të ndjerë të subjektit, të cilat nuk provojnë momentin e arkëtimit të vlerës, gjendjen e arkës së bashkëshortit në fund të vitit apo destinacionin e vlerave të pasqyruara në to. Përpos sa më lart, Komisioni administroi dokumentacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim “DPT”), që përbën akt me fuqi të plotë provuese, i të ardhurave që e kalojnë testin e ligjshmërisë në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016¹¹.

7.7. Aktet bashkëlidhur ankimit janë përgjithësisht fatura tatimore të bashkëshortit të subjektit dhe projekte, për të cilat është paguar gjatë periudhës 2008 – 2010. Mes akteve bashkëlidhur ankimit është paraqitur një bllok faturash të bashkëshortit të subjektit, i noterizuar, përfshirë një faturë të muajit janar 2009, me vlerë 10.625 euro. Faturat e tjera të vitit 2009 janë përtej muajit mars, në të cilin subjekti pretendon se u krye pagesa, si dhe periudha në të cilën mund të jenë krijuar të ardhura më të larta se nga sa ka përlllogaritur Komisioni, ndërsa faturat e vitit 2010 janë tej periudhës së shlyerjes së këstit të dytë¹². Po ashtu janë paraqitur nga subjekti edhe fatura të vitit 2008, të cilat nuk janë bërë pjesë e analizës së Komisionit, për shkak se nuk u deklaruan si kursime të vitit përkatës. Në kushtet që është e pamundur të konfirmohet momenti përkatës kur u arkëtuan vlerat e mësipërme, këto akte paraqesin vlerë provuese jopërcaktuese për efekt të përlllogaritjes së të ardhurave të ligjshme të disponuara për pagesat e kësteve të apartamentit.

7.8. Aktet me të cilat subjekti kërkon të provojë të ardhurat e vëllait për të kontribuar me huan për blerjen e automjetit, janë administruar nga Komisioni në shpjegimet e rezultateve të hetimit dhe në seancën dëgjimore. Këto akte nuk u pranuan nga Komisioni, pasi ekzistenca e marrëdhënies së huas nuk gjeti pasqyrim në kohën e krijimit të saj, ashtu sikurse as në deklaratën periodike dhe as në deklaratën *vetting*. Në kushtet kur këto akte i janë nënshtruar hetimit në Komision dhe nuk janë pranuar për arsye që nuk lidhen me mundësinë e paraqitjes së atyre, ato nuk përbëjnë provë të re për Kolegjin për t’u marrë nën hetim.

7.9. Edhe aktet, nëpërmjet të cilave subjekti kërkon të provojë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit në Turqi, në datat 18 – 21.11.2010, nga deklaruesi, z. Xh. B., i janë nënshtruar analizës së Komisionit. Kjo deklaratë nuk u pranua nga Komisioni dhe u konsiderua se marrëdhënia e bashkëpunimit mbeti në nivel deklarativ. Shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortit të subjektit, për

⁹ Komisioni ka kërkuar dokumentacion për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit që në tetor 2021.

¹⁰ Përkatësisht, në vlerën 2.180.000 lekë dhe në vlerën 2.000.000 lekë.

¹¹ 19. “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.

¹² Përkatësisht, faturat e datës 22.12.2010, me vlerë 170.000 lekë, dy fatura me vlerë 250.000 lekë secila dhe dy fatura me vlerë 2.000 euro secila.

këtë udhëtim janë përllogaritur në masën 330 euro në total ose 50 euro qëndrimi në ditë (150 euro tri ditë). Nëpërmjet deklaratës dhe provimit të marrëdhënies së bashkëpunimit, subjekti tenton të ulë nga shpenzimet vlerën nga 50 euro dita në 5 euro dita, dhe shpenzimi i udhëtimit të mbetet në vlerën 195 euro, bashkë me biletën e avionit. Për këtë pretendim të subjektit, analizuar në vijim në vendim, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se vlera që subjekti tenton të zbresë nga balanca e saj është minimale dhe mbetet e papërfillshme në totalin e burimeve të krijimit të pasurive për vitin 2010. Për rrjedhojë, edhe nëse do të konsideroheshin se paraqiten në përputhje me kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, këto akte nuk ndryshojnë analizën financiare në mënyrë të konsiderueshme. Si të tilla, nën dritën e germës “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, ato janë të panevojshme për vendimmarrjen.

7.10. Së fundmi, në të njëjtën linjë, edhe aktet e sjella me parashtimet përpara seancës në Kolegj u vlerësuan nga trupi gjykues i Kolegjit të panevojshme për vendimmarrjen, në kushtet që nga analiza integrale e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit ishte në gjendje të zgjidhte çështjen, duke e ndryshuar vendimin e Komisionit, edhe pa përfshirë këto akte në mesin e atyre, të administruara në cilësinë e provës.

7.11. Për sa më lart dhe duke konstatuar se procedura e ndjekur nga Komisioni nuk rezulton të jetë shoqëruar me të meta procedurale, të cilat mund të passillnin nevojën e korigjimit të tyre në Kolegj me seancë publike, sikurse as nuk rezulton se është e nevojshme të merren prova të reja apo të konstatohet ndryshe situata faktike, sipas kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues vendosi shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit Ermira Dedja, kundër vendimit të Komisionit, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i pretendimeve dhe shkaqeve të ankimit:

(i) Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me procesin e rregullt ligjor

8. Në këtë grup shkaqesh ankimi, subjekti konteston vendimmarrjen e Komisionit në çështjen e saj mbi baza të interpretimit të gabuar të ligjit si të trajtimit të saj të pabarabartë krahasuar me subjekte të tjera. Trupi gjykues i Kolegjit i gjeti të gjitha këto shkaqe të ankimit të pabazuara, përpos që të përsëritura e të dhëna përgjigje në një sërë çështjesh të trajtuara e arsyetuara më parë në vendime të tjera. Në vijim shtjellohet arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion.

8.1. Pretendimi i subjektit, se *u cenua* procesi i rregullt ligjor, meqenëse vendimi i Komisionit arrin në një konkluzion të ndryshëm nga ai i ILDKPKI-së, nuk qëndron dhe bën pjesë në rrethin e pretendimeve, të cilat kanë gjetur përgjigje shteruese në vendimmarrje të mëparshme. Konkretisht, Komisioni i Venecias, Gjykata Kushtetuese¹³, GjEDNj-ja në çështjen kyç “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”¹⁴, si dhe jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit, ka trajtuar në mënyrë të detajuar se rivlerësimi kryhet nga Komisioni dhe Kolegji, të cilët gjatë ushtrimit të këtij funksioni, ndihmohen nga organet e tjera të përcaktuara si ndihmëse. Opinionet dhe raportet e hartuara nga këto organe nuk janë të detyrueshme për t’u marrë në konsideratë nga organet e rivlerësimit, të cilat kryejnë

¹³ Me vendimin nr. 2/2017, paragrafi nr. 40.

¹⁴ Paragrafi 333 i vendimit, si dhe paragrafët 135–142, në: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/06/Vendimi-Xhoxhaj-k.-Shqiperise-Shqip.pdf>.

një hetim të thelluar dhe të pavarur në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nuk mund të argumentohet se përbën cenim të procesit të rregullt fakti që për të Komisioni arriti në një konkluzion të ndryshëm nga ai i ILDKPKI-së. Jo vetëm që institucionet e rivlerësimit janë të pavarura dhe kryejnë hetimin e tyre autonom, e për pasojë, jo domosdoshmërisht mund të arrijnë në të njëjtin konkluzion, por edhe sepse hetimi që kryejnë Komisioni e Kolegji është më i zgjeruar dhe përfshin edhe aspekte, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit të organeve ndihmëse.

8.2. Është i pabazuar në ligj dhe akte edhe pretendimi i subjektit se pozita e saj është rënduar padrejtësisht, me qëllim për ligjjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Këtë pretendim, subjekti e lidh me interpretimin e saj për mënyrën se si Komisioni do të duhet ta kishte kryer procesin dhe dhënë asaj mundësi të paraqiste argumente/prova për të provuar të kundërtën¹⁵. Përveç që subjekti nuk ka argumentuar se si është cenuar marrja e saj, nga kontrolli i procedurës së ndjekur në Komision, nuk u konstatua që subjektit t'i jetë mohuar e drejta për të paraqitur akte në kuadër të ushtrimit të të drejtës së mbrojtjes apo që ajo të mos ketë qenë e informuar me hapat e ndjekur gjatë tij nga Komisioni. Në kushtet që mes pyetësorit standard dhe atij shtesë ka kaluar një vit, ndërsa mes njohjes me rezultatet e hetimit dhe seancës dëgjimore kanë kaluar edhe pesë javë të tjera, nuk mund të argumentohet kohë e pamjaftueshme për të mbledhur akte apo përgatitur prapësime, përkatësisht. Gjatë këtyre dy periudhave, asaj i është dhënë mundësia të paraqesë akte dhe të njihet me përmbajtjen e fashikujve të Komisionit, ndërkohë që me rezultatet e hetimit ka qenë në dijeni edhe të problematikave dhe të konstatimit për mungesë burimesh. Konkretisht, pasi subjekti mori rezultatet e hetimit, në 3 dhjetor 2021, dhe iu lanë 20 ditë kohë që të paraqesë mbrojtjen/përmbysjen e barrës së provës, në datën 7 dhjetor 2021, nëpërmjet avokates, subjekti kërkoi të njihet me aktet e dosjes hetimore të Komisionit. Në datën 23 dhjetor 2021, subjekti dërgoi aktet dhe përgjigjet në përmbushje të barrës së provës. Në seancën dëgjimore, në datën 10 janar 2022, subjekti dorëzoi akte të tjera shtesë në kuadër të mbështetjes së shpjegimeve të saj. Po ashtu, ajo depozitoi akte të tjera në Komision edhe një ditë pas seancës dëgjimore. Gjatë hetimit dhe seancës dëgjimore në Komision, subjekti nuk paraqiti asnjë pretendim lidhur me cenimin e të drejtës së saj për ushtrimin e një mbrojtjeje sa më efektive. Për rrjedhojë, subjektit nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së dhe të nenit 42 të Kushtetutës.

8.3. Edhe pretendimi i subjektit, se nëpërmjet parashikimit për deklaram të pamjaftueshëm (pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016), ligjvënësi ka pasur për qëllim që të largojë nga sistemi i drejtësisë personat që janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme dhe kanë krijuar pasuri, dhe jo ata që kanë pasaktësi në deklaramet e tyre, është i pabazuar, përveçse i arsytuar gjerësisht dhe në mënyrë të përsëritur e shteruese në jurisprudencën e Kolegjit, në çështje të ngjashme ndër vite. Pa përsëritur sa është analizuar e arsytuar gjerësisht në vendime të mëparshme¹⁶, trupi gjykues çmon vetëm të rikonfirmojë se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë është vetëm një nga gjashtë situatat ligjore të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që sjell si pasojë shkarkimin. Këto situata janë autonome, jokumulative dhe janë pasqyruar qartazi si të tilla në dispozita të ndryshme të Aneksit të

¹⁵ Subjekti e mbështet këtë pretendim në vendimin nr. 17/2005, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁶ Shih ndër të tjera, vendimin e Kolegjit nr. 19/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori, vendimin e Kolegjit nr. 1/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Albina Spaha; vendimin e Kolegjit nr. 26/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini.

Kushtetutës dhe në pjesë të ndryshme të ligjit nr. 84/2016, duke nisur nga neni 30 e deri në nenin 59. Së dyti, Komisioni ka marrë masën disiplinore të shkarkimit për subjektin, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme¹⁷ në krijimin e dy pasurive të saj dhe e pasaktësisë/mosdeklarimit në deklaratën *vetting* të burimit të krijimit të pasurive, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Duke abstraguar nga mënyra e ndryshme se si trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi të njëjtat fakte dhe dokumente, parimisht, masa disiplinore e shkarkimit për deklarim të pamjaftueshëm, për shkak të pasaktësisë në deklaratën *vetting* dhe/ose mungesë burimesh, është qasje e bazuar në ligj. Në jurisprudencën e tij, Kolegji ka arsyetuar, ndër të tjera, se konstatimi i gjendjes në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme apo të pasaktësisë së deklarimeve, nuk kushtëzohet nga konstatimi i ekzistencës së ndonjë rrethane tjetër ligjore, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, apo alternativat e parashikuara nga neni 61 i të njëjtit ligj, ndryshe nga sa pretendon subjektin se shkelja/sjellja duhet të jetë e një rëndësie të caktuar.

8.4. Pretendimi tjetër për shkelje të barazisë para ligjit në çështjen e subjektit krahasuar me raste të ngjashme, në të cilat, sipas saj, Komisioni ka arsyetuar ndryshe për pasaktësinë e deklarimeve, po ashtu vlerësohet i pakuptimtë, në kushtet që referohet një vendim i ndryshuar¹⁸ nga Kolegji, që në korrik 2019, ndërkohë që ankimi i subjektit daton tri vite më pas. Së fundmi, edhe duke abstraguar nga fakti që trupi gjykues i Komisionit ka qenë i ndryshëm pjesërisht në këto dy çështje, vendimmarrja për secilin rast diktohet nga rrethanat e faktit dhe nga situata në tërësi e subjekteve të rivlerësimit, e për pasojë, analogjitë në pamje të jashtme janë të pamundura të paraqiten si shkak përcaktues për të argumentuar shkeljen e barazisë para ligjit. Në përmbledhje, trupi gjykues konkludon se pretendimet e subjektit, që lidhen me mungesën e zbatimeve të parimeve të procesit të rregullt ligjor, nuk janë të mbështetura në situatën faktike-ligjore.

8.5. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dhe aktet në fashikujt e Komisionit, vlerësoi se vendimi objekt kontrolli i Komisionit duhet të ndryshohet, pasi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj e prova. Arsyetimi mbi të cilin u bazua ky konkluzion shtjellohet në vijim.

(ii) Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

9. Apartamenti me sipërfaqe 104 m², në Shkodër

9.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti e deklaroi këtë pasuri të blerë me kontratën e sipërmarrjes së datës 29.03.2010, në bashkëpronësi me fëmijët, me vlerë 4.680.000 lekë. Për herë të parë, këtë pasuri subjekti e deklaroi në deklaratën periodike të vitit 2009, në të cilën së bashku me vlerën totale të pasurisë ka referuar edhe shlyerjen e këstit të parë, në vlerën 2.180.000 lekë. Në këtë deklaratë periodike, subjekti deklaroi edhe të ardhura të saj nga paga, të ardhura të bashkëshortit

¹⁷ Në shumën 1.518.666 lekë, për pagimin e këstit të parë, në mars të vitit 2009 dhe 1.798.672 lekë, për pagimin e këstit të dytë, në mars të vitit 2010; si dhe mungesë burimesh të ligjshme, në shumën 590.589 lekë, në datën 23.03.2007, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, shoqëruar me konstatimin e deklarimeve të pasakta në deklaratën *vetting*.

¹⁸ Subjekti referon vendimin e Komisionit nr. 46/2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori. Paragrafët 22.14 – 22.17 të vendimit të Kolegjit: https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf

si person fizik dhe të ardhura të vjehrrës nga pensioni i pleqërisë. Njëjtë si në deklaratën periodike, ashtu edhe në deklaratën *vetting*, subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të pasurisë.

9.2. Komisioni konkludoi se subjekti: (i) ka kryer deklaram të pasaktë, sepse nuk e deklaroi interesat pasurorë mbi këtë apartament, që në vitin 2008, dhe këstin e parë të paguar, dhe (ii) nuk deklaroi burimin e krijimit të pasurisë dhe se (iii) u gjend në kushtet e mungesës së të ardhurave të ligjshme të shlyerjes së të dyja kësteve të apartamentit. Ky konkluzion u bazua, ndër të tjera, në konstatimin e Komisionit se subjekti nuk shpjegoi bindshëm që nuk e zotëronte apartamentin para datës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, nuk ka deklaruar në deklaratat periodike dhe as atë *vetting* burimin e krijimit të pasurisë, dhe se nga analiza financiare e kryer, ajo rezultonte me mungesë burimesh të ligjshme për pagesat e kësteve për apartamentin, përkatësisht në vlerat (-) 1.518.666 lekë dhe (-) 1.798.672 lekë, në mars 2009 dhe 2010.

9.3. Subjekti ka kundërshtuar në tërësi dhe me argumente veçmas secilin prej këtyre aspekteve. Ajo argumenton në ankim se deklarimi ka qenë i saktë dhe ka pasur mundësi për të krijuar pasurinë me të ardhura të ligjshme. Konkretisht, subjekti potencon se:

9.3.a. Për sa kohë nuk ishte në marrëdhënie juridike me investitorin, nuk kishte as objekt deklarimi në vitin 2008.

9.3.b. Po ashtu, ka deklaruar saktë shlyerjen e kësteve në deklaratat periodike për vitet 2009 dhe 2010. Ka deklaruar për vitin 2009 krijimin e pasurisë, detajet për të dhe vlerën e paguar si këst i parë, prej 2.180.000 lekësh, ndërsa për vitin 2010, subjekti deklaroi kontratën e *shitjes*, datë 29.03.2010, dhe shënoi se është likuiduar edhe vlera prej 2 milionë lekësh, si këst i dytë.

9.3.c. Në ankim, sikurse edhe gjatë hetimit në Komision, subjekti shprehet se, për shkak të mënyrës se si ajo e ka kuptuar deklaratën, duke deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të saj si person fizik, ezauroi detyrimin e deklarimit të burimit të pagimit të kësteve të apartamentit dhe mundësinë e shlyerjes së kësteve.

9.3.d. Ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesat e kësteve. Për këstin e *parë*, në vlerën 2.180.000 lekë, shlyer në mars 2009, subjekti kundërshton përlllogaritjen e Komisionit me të ardhurat përpjesëtimore të tremujorit të parë të vitit 2009,¹⁹ pasi pretendon se pagesa e kështit të parë u likuidua nga të ardhurat e vitit 2008, të bashkëshortit. Po ashtu, subjekti sqaron se shuma e të ardhurave të vitit 2008 iu vu në dispozicion familjes pas pagimit të tatimit, në muajin mars të vitit 2009. Pas shlyerjes së tatimeve të biznesit të vogël, fitimi neto i përlllogaritur u përdorur për pagesën e këtij kësti. Të njëjtin shpjegim, subjekti paraqiti edhe për shlyerjen e kështit *të dytë*, me vlerë 2 milionë lekë.

9.4. Nga analiza e kryer duke mbajtur në konsideratë sa rezulton nga aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, me fokus sasinë e të ardhurave të ligjshme të dokumentuara dhe të krijuara nga aktiviteti privat i bashkëshortit të subjektit, trupi i Kolegjit konstatoi se kjo pasuri është krijuar me të ardhura të ligjshme. Në të njëjtën linjë, pasaktësitë e subjektit u vlerësuan me peshë dytësore. Komisioni ka gabuar në vlerësimin e tij lidhur me burimet që shërbyen për shlyerjen e dy kësteve të apartamentit në

¹⁹ Periudha tatimore përputhet me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2006/01/30/5/38fa9fac-2577-403a-bcf3-7d4cafba86b6>

Shkodër, me vlerë 4.680.000 lekë. Ndërkohë që, edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të *pasaktë* në deklaratën *vetting*, pasi nuk ka deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie, dokumentacioni ligjor në fashikull konfirmon të ardhura të ligjshme të *mjaftueshme* të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, nga aktiviteti i tij si person fizik, arkitekt. Këto të ardhura të tij, të cilat sipas dokumentacionit të përcjellë nga organet tatimore arrijnë në total në vlerën prej thujse 9.000.000 lekë neto, vetëm për periudhën kohore nga viti 2008 deri në vitin 2011, u përfshinë në analizën e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti dhe personi i lidhur, për të përballuar shlyerjen e dy kësteve në kohën dhe vlerat e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes.

9.5. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti të besueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, për dinamikën e pagesave në sajë të të ardhurave nga aktiviteti privat i bashkëshortit, duke mbajtur në konsideratë që: (i) pasaktësia në deklaram nuk shoqërohet nga mungesë burimesh për të shlyer pagesat e kësteve, ndërkohë që momenti kur janë kryer pagesat përkon me gjenerimin e të ardhurave të konsiderueshme të ligjshme e të deklaruara, qoftë nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, apo nga personi i lidhur në organet tatimore¹; (ii) përputhjen e deklaramit periodik vjetor të kohës nga subjekti, me vlerat e deklaruara e të tatuara; (iii) përputhjen e këtyre deklarameve me mënyrën se si subjekti deklaroi burimet e pasurive ndër vite; (iv) faktin që gjatë periudhës së disponimit të të ardhurave dhe shlyerjes së kësteve, nuk u evidentuan shpenzime të tjera; (v) kohën e shkurtër mes momentit në të cilin të ardhurat nga aktiviteti privat u evidentuan e u disponuan, dhe pagesës së kësteve sipas kontratës së sipërmarrjes - veprime të ndodhura brenda muajit mars të viteve 2009 dhe 2010, kur u shlyen këstet respektive dhe, së fundmi, (vi) rrethanat faktike konkrete objektive, të cilat ia pamundësojnë subjektit njohjen e disa detajeve të mënyrës se si personi i lidhur ka menaxhuar arkën e personit fizik, në kushtet që ai ka ndërruar jetë, në vitin 2012.

9.6. Në kushtet që e vetmja pasuri e paluajtshme e subjektit, e krijuar me të ardhurat e përfituara gjatë periudhës së rivlerësimit, përkon me momentin kur aktiviteti privat i personit të lidhur gjeneronte të ardhura të konsiderueshme të ligjshme, të konfirmuara dhe të deklaruara në institucionet shtetërore, në një vlerë që arrin thujse dyfishin e çmimit të pasurisë në fjalë, ngarkimi i subjektit me masë disiplinore për shkak të pasaktësive të konstatuara në deklaramet e saj, do të ishte disproporcional dhe i padrejtë. Pasaktësitë e subjektit në mosdeklaramin ekzaktësisht të burimit të krijimit apo të gjendjes së tyre në arkën e personit fizik, në momentin e kryerjes së pagesave, ndërkohë që personi i lidhur që ka krijuar këto të ardhura, ka ndërruar jetë, disa vite përpara se të niste procesi i rivlerësimit, e në këto kushte vështirëson dhe e shton peshën e përgjegjësive që ajo (subjekti) mban në proces, u vlerësuan nga trupi gjykues në balancën tërësore të aspekteve, të cilat arsyeshëm shkojnë në drejtim të analizës me objektivitet dhe proporcionalitet të situatës konkrete. Ky konkluzion është rrjedhojë e analizës dhe i arsyetimit që shtjellohet në vijim, për secilin aspekt.

(a) *Pasaktësitë në deklaramin e interesave pasurorë për apartamentin në deklaratat periodike*

9.7. Komisioni konstatoi se subjekti duhet të kishte deklaruar, që në deklaratën për vitin 2008, krijimin e interesit pasuror për këtë apartament, në kushtet që: (i) në muajin nëntor të vitit 2008, ky apartament kishte faturim nga OSHEE-ja dhe (ii) lidhja e kontratës me OSHEE-në, sipas legjislacionit të kohës, kushtëzohet nga provueshmëria e pronësisë, qirasë apo sipërmarrjes.

Komisioni arriti në konkluzionin se marrëdhënia me shitësin është krijuar që në vitin 2008, e për rrjedhojë, subjekti kishte detyrimin ta deklaronte atë në deklaratën periodike.

9.8. Subjekti potencon se kontrata e porosisë është lidhur në mars të vitit 2010, ndërsa në vitin 2008 nuk e posedonte këtë pasuri. Lidhja e kontratës me OSHEE-në, si për çdo banor të godinës, u bë me konsensus, që në tetor të vitit 2008, kur ranë dakord në mënyrë verbale me shitësin për çmimin dhe mënyrën e shlyerjes së kësteve. Konsumi i energjisë elektrike tregon se banimi nuk ka filluar deri në mars të vitit 2009. Sipas subjektit, qëndrimi i Komisionit është i paqartë, pasi ajo nuk e kupton ku qëndron shkelja e saj, në një kohë që nuk kishte objekt deklarimi në deklaratën periodike. Me referim në jurisprudencën e Kolegjit²⁰, ajo dedukton se, në kuadër të procesit të rivlerësimit, saktësia e deklarimit lidhet me deklaratën *vetting* dhe jo me deklaratat periodike.

9.9. Trupi gjykues i Kolegjit e mori në analizë këtë pretendim të subjektit dhe e gjeti bindës. Konkluzioni i Komisionit që e lidh pasaktësinë e deklarimit në deklaratën periodike, me saktësinë e deklarimit në deklaratën *vetting*, duke e ngarkuar subjektin me përgjegjësi në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kushtet që nga analiza financiare rezulton se periudha në fjalë përkon me të ardhura të konsiderueshme të bashkëshortit të subjektit, nga aktiviteti privat, nuk qëndron.

9.10. Nga aktet në dosje vërehet se ndërtesa ku ndodhet apartamenti objekt analize ka pasur për arkitekt bashkëshortin e subjektit. Akti i kolaudimit në dokumentin e ASHK-së nuk ka datë, por leja e shfrytëzimit të godinës, që e cilëson objektin *të gatshëm për shfrytëzim*, është e datës 25.08.2009. Bashkëshorti i subjektit, në datën 29.03.2010, ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me investitorin/pronarin e godinës. Palët kanë zgjedhur që, në të njëjtën datë, 29.03.2010, të autentifikojnë pranë noteres nënshkrimet e kontratës. Në këtë kontratë, çmimi i apartamentit është vendosur 4.680.000 lekë dhe, që deri në datën e lidhjes së kontratës, bashkëshorti i subjektit/blerësi ka shlyer 4.180.000 lekë, nga të cilat 2.180.000 lekë janë likuiduar gjatë vitit 2009 dhe 2.000.000 lekë sot (29.03.2010). Kësti i fundit, prej 500.000 lekësh, do të shlyhej me firmosjen e kontratës së shitblerjes së apartamentit.

9.11. Në deklaratën periodike për vitin 2008, dorëzuar në datën 31.03.2009, subjekti nuk e ka deklaruar këtë apartament qoftë në rubrikën e *interesave të tjera* apo të të drejtave reale²¹, dhe as si adresë banimi. Këto aspekte janë deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2009, përfshirë edhe vlerën totale dhe pjesën e shlyer. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë, duke referuar krijimin e saj me kontratën e sipërmarrjes së datës 29.03.2010. Subjekti pretendon, sikurse dhe gjatë hetimit në Komision, se bashkëshorti ka pasur paraprakisht një marrëveshje verbale me shitësin që të lidhë kontratën e energjisë elektrike. Sipas pyetësorit nr. 1, ndryshimi i banimit u diktua për shkak të amortizimit të apartamentit të parë, që kishte passjellë probleme shëndetësore

²⁰ Subjekti referon vendimin e Kolegjit nr. 35/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Arqile Koça, paragrafi 25. Në këtë vendim, Kolegji ka arsyetuar: “Mosdeklarimi i marrjes në dorëzim të tetë pasurive të paluajtshme në vitin 2009 (pa fituar ende titullin e pronësisë mbi to), në vlerësim të trupit gjykues, nuk përbën shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, mbi deklarimin e pasurive të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë titulli i pronësisë së këtyre sendeve të paluajtshme ende nuk kishte kaluar te subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues konstatoi se, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni në vendim, detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim dhe zotërim të subjekteve rivlerësuese është përcaktuar në mënyrë të shprehur për herë të parë në legjislacionin e posaçëm që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016. [...]”.

²¹ Përfshin: gëzimin, disponimin dhe përdorimin. Subjekti nuk mbarnte asnjë nga këto të drejta.

për djalin e vogël. Me fjalë të tjera, subjekti ka pranuar se ky apartament është porositur verbalisht, që në momentin e lidhjes së kontratës me FSHU/OSHEE-në, nga bashkëshorti i subjektit. Nga përgjigjja e FSHU/OSHEE-së konstatohet se lidhja e kontratës së energjisë për këtë apartament, në emër të bashkëshortit të subjektit, është bërë në 31 tetor 2008. Faturimi i lëshuar nëpërmjet FSHU/OSHEE-së pasqyron shpenzime të papërfillshme në muajin nëntor 2008. Nga muaji mars i vitit 2009 e në vijim, konsumi i energjisë elektrike është rritur, ashtu sikurse edhe tarifimi.

9.12. Komisioni pranoi se kësti i parë për apartamentin u shlye në muajin mars të vitit 2009 dhe mosdeklarimi i marrëveshjes së krijuar në mënyrë verbale, në deklaratën periodike për vitin 2008, nuk ka pasur asnjë efekt mbi analizën financiare. Pavarësisht nga ky konkluzion, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka qenë në kushtet e pasaktësisë sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të mosdeklarimit në deklaratën periodike vjetore, që rregullohet nga ligji nr. 9049/2003.

9.13. Deklaratat periodike vjetore të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji²², dhe kontrolli i pasurisë së deklaruar në deklaratën *vetting* mund të krahasohet me deklaramet në deklaratat periodike, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar²³. Deklaramet e subjektit në deklaratat periodike, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurie, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar (në vijim, “ligji nr. 9049/2003”) parashikojnë se objekt deklarimi janë: *a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil*. Në formularin e deklaratës periodike vjetore të vitit 2008 kërkohet që të përshkruhet hollësisht pasuria e luajtshme apo e paluajtshme, e regjistruar ose jo në regjistrat publikë, apo interesat e tjera.

9.14. Nën dritën e dispozitave të mësipërme dhe në linjë me arsyetimet e konsoliduara tashmë, konkluzioni i Komisionit për efektin në procesin e *rivlerësimit* të mosdeklarimit të të drejtave reale mbi këtë pasuri, në deklaratën për vitin 2008, për shkak të faktit që konsumi i energjisë, në nëntor 2008 deri në mars 2009, është 0 (zero) kilovat, është i paqartë, edhe duke abstraguar nga fakti nëse subjekti duhet ta deklaronte këtë ndryshim pasuror. Me fjalë të tjera, nga aktet rezulton se subjekti ka paguar fillimisht një vlerë 5.400 lekë tarifimi energjie, nuk ka konsum energjie në vijim dhe ka deklaruar krijimin e pasurisë në deklaratën për vitin 2009, që përkon me fillimin e përdorimit të apartamentit – duke gjykuar nga sa deduktohet nga faturat e energjisë, që janë të rregullta, nisur nga marsi 2009. Së dyti, nga leja e shfrytëzimit, lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Shkodër, rezulton se apartamenti, sikurse ka shpjeguar subjekti, është bërë i banueshëm në vitin 2009. Këto fakte dëshmojnë që shpjegimet e subjektit, se nuk jetoi në apartamentin në fjalë në vitin 2008, janë të mbështetura me akte të kohës. Nga ana tjetër, efekti i mosdeklarimit në deklaratën periodike për vitin 2008, në kushtet që, gjithsesi, pasuria dhe detyrimet e shlyera janë deklaruar për vitin 2009, në funksion të procesit të *rivlerësimit* dhe deklarimit në deklaratën *vetting*, është inekzistent. Për rrjedhojë, konstatimi i Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën periodike të vitit 2008, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33,

²² “[5.] Deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit”.

²³ *Shih, ndër të tjera, vendimin nr. 37/2023 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Bardhok Lleshi.*

të ligjit nr. 84/2016, është i pasaktë. Për sa kohë edhe në analizën përfundimtare të kësaj pasurie, Komisioni vlerësoi se deklaratimet e pasakta lidhen me mosdeklarimin e burimit në deklaratën *vetting* dhe jo me elementin e deklaratës periodike, ky vlerësim i pashoqëruar me ndonjë efekt financiar për pasurinë në këtë vit, mbetet pa peshë përcaktuese²⁴.

(b) *Për mosdeklarimin e detyrimit të mbetur në deklaratat periodike 2010 – 2013*

9.15. Një tjetër aspekt që Komisioni mbajti në konsideratë, si përcaktues në vlerësimin e pasurisë objekt analize, ishte edhe mosdeklarimi i detyrimit të mbetur ndaj shitësit, në deklaratat periodike për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013. Subjekti ka potencuar në Komision se, në vitin 2009, shleu këstin e parë të apartamentit, sikurse deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2009. Në ankim, ajo potencon se, duke deklaruar vlerën totale dhe vlerën e kësteve që shleu në vitet 2009 – 2010, automatikisht kuptohej që detyrimi i mbetur ishte 500.000 lekë. Pasi e informoi ILDKPKI-ja, duke nisur nga deklarata periodike për vitin 2014, ajo ka deklaruar edhe detyrimet. Kjo mënyrë përfshin edhe deklaratën *vetting*, e cila është objekt i kontrollit të organeve të rivlerësimit. Mosdeklarimi i detyrimit, përpara konstatimit të ILDKPKI-së, ka ndodhur në mënyrë të paqëllimshme dhe për arsye të moskuptimit të mënyrës së deklarimit.

9.16. Nga aktet në fashikull rezulton se, në deklaratën për vitin 2009, subjekti ka deklaruar krijimin e pasurisë në fjalë, detajet e tjera të çmimit dhe sipërfaqes, dhe shlyerjen e vlerës 2.180.000 lekë, si këst i parë nga totali. Detyrimi i mbetur shitësit nuk është pasqyruar në seksionin përkatës. Në deklaratën periodike për vitin 2010, subjekti deklaroi kontratën e *shitjes* nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 29.03.2010²⁵, dhe shënoi se është likuiduar edhe vlera prej 2 milionë lekësh, si këst i dytë. Njësoj me një vit më herët, subjekti nuk e deklaroi pjesën e mbetur të detyrimit.

9.17. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, referuar formularit që detajon mënyrën e deklarimit sipas ligjit nr. 9049/2003, kërkon përshkrim të hollësishëm të detyrimit financiar, përfshirë: shumën totale, në lekë ose valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit, shumën e shlyer dhe gjendjen e mbetur të pashlyer. Rezulton se, pasi është thirrur për shpjegime në ILDKPKI, me përgjigjet e dhëna në 27 mars 2015, subjekti është shprehur se detyrimi i mbetur, prej 500.000 lekësh, *nuk* ishte shlyer ende. Ndërkohë, sikurse thekson subjekti, në deklaratat periodike vjetore në vijim, duke nisur nga deklarata periodike për vitin 2014, dorëzuar në datën 30.03.2014, subjekti ka shënuar rregullisht detyrimin e mbetur të pashlyer. Nga këto akte rezulton se subjekti ka reflektuar korigjimet e udhëzuara nga organi përkatës për mënyrën e deklarimit sipas ligjit nr. 9049/2003, duke nisur nga marsi 2014. Në këto kushte, duke qenë se subjekti ka marrë masa dhe korrigtuar mënyrën e deklarimit në përputhje me ligjin e kohës, vite përpara deklaratës *vetting* dhe

²⁴ *Shih, ndër të tjera, vendimin e Kolegjit nr. 31/2021 (JR), që i përket subjektit Gurali Brahimllari (paragrafi 21.7) [...] Në interpretim të dispozitave të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe e ligjit është e tillë, që nga ky proces i rivlerësimit të verifikohen dhe të gjithë ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre. Ballafaqimi i deklaratimeve periodike me ato të bëra në deklaratën e pasurisë *vetting*, në vitin 2017, u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshetje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe pasurisë së deklaruar; vendimin nr. 37/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi (paragrafi 10.12) [...] Në të kundërt, pasaktësitë e pretenduara në deklaratimet periodike nuk mund të shërojnë dhe as të shpjegojnë mungesën e burimeve të ligjshme, që rezulton nga analiza financiare që bëhet mbështetur mbi këto deklarime, e cila mbetet dhe konsiderohet si shkak shkarkimi sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016; si dhe vendimin nr. 28/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha (paragrafi 8.15).*

²⁵ *Ekstremitetet i përkasin autentifikimit të nënshkrimeve të kontratës së sipërmarrjes.*

procesit të rivlerësimit, është e pamundur të argumentohet se veprimet e saj kanë sjellë efekt mbi procesin e rivlerësimit apo pamundësuar atë. Për më tepër, edhe duke abstraguar nga fakti që, sikurse sqaron subjekti, vlera e mbetur e pashlyer mund të deduktohet nga një llogari e thjeshtë matematike e që subjekti ka deklaruar edhe shlyerjen në vijim, në referim të deklaratave periodike deri në vitin 2018 dhe të akteve të administruara nga Komisioni, ky detyrim është mbartur deri në vitin 2021, kur kaloi pronësia dhe u shlye vlera.

9.18. Për sa më sipër, mosdeklarimi i detyrimit të mbetur në deklaratat e viteve 2009 – 2013 përbën shkelje të ligjit nr. 9049/2003, të cilën subjekti e ka evidentuar gjatë kontrollit dhe shëruar, duke mos krijuar asnjë pamundësi për organet e rivlerësimit në analizën e deklarimit në deklaratën *vetting* dhe në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit thekson se deklaratat e viteve 2009 – 2013 mund të përbëjnë shkak për marrje të masës disiplinore ndaj subjektit, në kuadër të procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Qasja e Komisionit, duke marrë në konsideratë këto aspekte në rivlerësim, vlerësohet e pabazuar ndërsa pretendimet e subjektit janë të drejta.

(c) Për mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë në deklaratën vetting

9.19. Gjatë hetimit në Komision, subjekti deklaroi se si burimin i krijimit të pasurisë shërbyen të ardhurat e bashkëshortit nga puna e tij si arkitekt/inxhinier projektues. Konkretisht, në pyetësonin standard, subjekti është shprehur se përfitoi të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit të saj, nga viti 2008 deri në vitin 2011, dhe vlerat përkatëse²⁶. Në pyetësonin shtesë (nr. 1), pyetur për pagesën e kësteve, subjekti shpjegoi se përdori të ardhurat e bashkëshortit dhe se, duke deklaruar të ardhurat e krijuara nga ky aktivitet, për vitet 2008 – 2011, e konsideroi të ezauruar detyrimin e deklarimit të burimit të pasurisë. Sipas shpjegimeve të subjektit, “nuk kishte arsye mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë, për aq kohë sa të ardhurat ishin të ligjshme dhe të tatuara”. Së bashku me këto përgjigje, subjekti paraqiti në Komision edhe dokumentacion nga tatimet për të ardhurat e bashkëshortit të saj të ndjerë.

9.20. Në rezultatet e hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë objekt analize, me arsyetimin se vjen në kundërshtim me pikat 1 dhe 2, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikën 1, të nenit 31, të ligjit nr. 84/2016, dhe të shtojcës nr. 2²⁷ të këtij ligji. Përfundimisht, Komisioni konkludoi në vendim se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në deklaratën *vetting*. Në linjë me sa më lart, Komisioni shprehet se pasaktësia e deklarimit të subjektit vështirësoi analizimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në vitet përkatëse.

9.21. Subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim gjatë gjithë procesit dhe në ankim, duke potencuar se mënyra se si ajo e ka kuptuar deklaratën ishte që, duke deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të saj, i regjistruar si person fizik, inxhinier projektues, ezauroi detyrimin e deklarimit të burimit të pagimit të kësteve të apartamentit dhe përmbushi në këtë mënyrë edhe

²⁶“Po kam përfituar të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit tim, shtetasit A. D. [...] për vitet 2008, vlerën 3.765.659 lekë; 2009, vlerën 2.769.062 lekë; 2010, vlerën 1.012.544 lekë; 2011, vlerën 1.270.189 lekë”.

²⁷ “Deklaratë e pasurisë”.

detyrimin e deklarimit të burimit të të ardhurave të fituara në mënyrë të ligjshme, që tregojnë mundësinë e shlyerjes së kësteve.

9.22. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se konstatimi i mungesës së konkretizimit të burimit të krijimit të pasurisë është i drejtë, qoftë për sa i përket deklaratës *vetting*, ashtu edhe deklaratave periodike. Ndër deklaratat periodike të kohës rezulton se subjekti në përshkrimin e burimeve në vitet në të cilat ka deklaruar pasuri të krijuara, nuk ka ruajtur një mënyrë të caktuar deklarimi.²⁸ Ka vite në të cilat subjekti ka deklaruar si burim: *e fituar në ligjin për privatizimin e banesave shtetërore; dëshmi trashëgimi; apo akt dhurimi*, ndërkohë që ka edhe vite në të cilat subjekti nuk deklaroi burime të krijimit të pasurisë²⁹.

9.23. Në deklaratën *vetting*, në katër pasuri të deklaruara nga subjekti, për dy prej tyre nuk deklarohet burimi, ndërsa për dy të tjera, subjekti e përshkruan burimin. Një ndër pasuritë që nuk deklarohet burimi, është apartamenti objekt analize dhe tjetra është automjeti “Golf” – krijuar në vitin 2007, të dyja objekt ankimi në Kolegji. Për dy pasuri të tjera të paluajtshme, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit. Të dy këto pasuri u vlerësuan pa asnjë problematikë nga Komisioni. Në këtë mënyrë, me konsideratë që në deklaratën *vetting*, për dy nga pasuritë, subjekti e deklaroi burimin e krijimit, kjo nënkupton se edhe për dy pasuritë e tjera (objekt ankimi) duhet ta kishte të qartë mënyrën e deklarimit dhe mbartte detyrimin e deklarimit të burimit të krijimit të tyre.

9.24. Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës përcakton jo vetëm detyrimin e deklarimit të burimit të krijimit të pasurisë, por edhe përgjegjësinë e subjekteve që ta shpjegojnë atë bindshëm, sikurse analizuar gjerësisht edhe nga praktika e Kolegjit. Për rrjedhojë, mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë në deklaratën *vetting* përbën deklarim të pasaktë në një lexim *a contrario* të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konkluzioni i Komisionit ka qenë i drejtë. Burimi i krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi u deklarua për herë të parë gjatë hetimit administrativ në Komision. Nga ana tjetër, konstatimi i Komisionit për pasaktësinë që përfshin edhe deklaratat periodike vjetore, nuk vjen në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 84/2016, e as me jurisprudencën e Kolegjit në këtë drejtim. Për pasojë, ky aspekt nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit³⁰.

9.25. Për sa më lart, edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, deklarimi i subjektit në deklaratën *vetting* nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Subjekti nuk ka përmbushur detyrimin e deklarimit të burimit të krijimit të pasurisë objekt analize, veprim ky që vjen në kundërshtim me pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, sikurse arsyetuar gjerësisht në hyrje të analizës për këtë pasuri dhe në vijim, ky konkluzion u vlerësua në balancë me aspektet e tjera që rezultuan gjatë kontrollit të kësaj pasurie.

²⁸ Për shembull: në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2007, në përshkrimin e automjetit tip “Golf”, subjekti nuk e ka deklaruar burimin. Për krijimin e depozitës në vitin 2007, subjekti deklaroi si burim: nga paga e saj.

²⁹ Deklarata e parë e vitit 2003; Deklarata periodike për vitin 2006; Deklarata periodike për vitin 2007; Deklarata periodike për vitin 2012.

³⁰ Shih ndër të tjera, vendimin e Kolegjit nr. 25/2021(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Ardian Ylli, prg. 30.4.

(d) *Për mundësinë e shlyerjes së kësteve të blerjes së apartamentit me burime të ligjshme*

9.26. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi të ardhura nga biznesi i bashkëshortit si inxhinier projektues, në vlerën 8.817.454 lekë. Gjatë hetimit në Komision, ajo theksoi se këstet e paguara për apartamentin kishin për burim të ardhurat e gjeneruara nga puna e bashkëshortit si inxhinier projektues/arkitekt. Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër³¹ (në vijim “DRT Shkodër”) Komisioni evidentoi se: (i) për vitin 2008, të ardhurat ishin 6.691.800 lekë, ndërsa fitimi tatimor ishte 4.184.065 lekë; (ii) për vitin 2009, të ardhurat e përlllogaritura ishin në vlerën 7.034.850 lekë, ndërsa fitimi tatimor ishte në vlerën 3.076.736 lekë dhe (iii) për vitin 2010, të ardhurat ishin në vlerën 1.214.680 lekë, ndërsa fitimi tatimor ishte vlerën 1.136.382 lekë. Për këto të ardhura, DRT Shkodër konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore. Nga përlllogaritja e kryer mbi këtë akt rezultoi fitim në total 8.771.254 lekë³². Pas kësaj analize, për të vlerësuar mundësinë e shlyerjes së kësteve, Komisioni i llogariti të ardhurat vjetore të bashkëshortit të subjektit në mënyrë përpjesëtimore³³ (të ardhurat e vitit i pjesëtoi me tre), meqenëse subjekti shpjegoi se pagesat janë kryer në fund të muajit mars të viteve 2009 dhe 2010.

9.27. Në përfundim, Komisioni nuk e konsideroi bindës shpjegimin e subjektit se të ardhurat e bashkëshortit nga viti paraardhës, nga arka, janë përdorur për shlyerjen e kësteve të apartamentit. Si pasojë, Komisioni konkludoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme përkatësisht në shumën (-) 1.518.668 lekë dhe (-) 1.798.672 lekë për secilin këst, në mars 2009 dhe 2010, duke u gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara, Komisioni përlllogariti vetëm të ardhurat e bashkëshortit dhe të ardhurat nga paga e subjektit, për periudhën nga janari në mars të viteve në fjalë. Komisioni theksoi se, në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar të ardhurat nga aktiviteti si gjendje në fund të viteve 2008 dhe 2009, sipas ligjit nr. 9049/2003, këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagimin e kësteve të apartamentit në fund të muajit mars të vitit 2009 dhe të vitit 2010. Gjithashtu, Komisioni arsyetoi se gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk paraqiti asnjë akt për të provuar gjendjen e likuiditeteve të aktivitetit të bashkëshortit në arkën e personit fizik, deri në datën e deklarimit të saj periodik, duke arsyetuar se, pavarësisht se kur deklarohet fitimi për efekt tatimor, pjesa e pashpenzuar nga fitimet e vitit paraardhës duhet të ishte deklaruar në deklaratën periodike si gjendje *cash*.

9.28. Sikurse përmbledhur më sipër, subjekti ka theksuar në mënyrë konsistente se përlllogaritja e fitimit neto të vitit paraardhës, për shkak të natyrës së aktivitetit tregtar të bashkëshortit, është kryer *në fund* të muajit mars të vitit në vijim, për efekt deklarimi, dhe se ajo nuk ka pasur dijeni për gjendjen e arkës. Të ardhurat e vitit paraardhës janë përdorur për shlyerjen e kësteve të apartamentit. Përlllogaritja e të ardhurave nga aktiviteti i inxhinierit/si person fizik, për nga natyra e punës, nuk mund të ndahet në mënyrë proporcionale, pasi kjo kategori tatimpaguesish nuk kanë

³¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 22.10.2021 dhe shkresa nr. {**} prot., datë 19.10.2021.

³² Komisioni përlllogariti fitimin neto, duke zbritur nga fitimi bruto taksën vendore të biznesit të vogël dhe tatimin mbi të ardhurat e biznesit të vogël (bazuar në vitin kur janë paguar) dhe pasqyroi në analizën financiare fitimin neto që rezultoi nga këto përlllogaritje.

³³ Komisioni përlllogariti në mënyrë përpjesëtimore fitimin neto nga aktiviteti si person fizik i bashkëshortit të subjektit, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, për periudhën janar – mars 2009, duke përlllogaritur: 3 muaj x 2.645.329 lekë / 12 muaj, nga ku rezultoi vlera 661.332 lekë, ndërsa për vitin 2010 rezultoi vlera 201.327 lekë.

pasur detyrimin të hartonin pasqyrat financiare apo të deklaronin gjendjen e arkës në fund të vitit. Këto të ardhura nuk disponoheshin në dhjetor të viteve përkatëse, por vetëm në momentin e mbylljes së llogarisë financiare, në muajin mars të vitit në vijim. Sipas konfirmimit të DRT-së Shkodër, bashkëshorti krijoi të ardhura në vlerën 4.164.065 lekë, vetëm për vitin 2008. Nëse këtyre të ardhurave iu zbret këstin e shlyer në mars të vitit përkatës, atëherë rezulton me mundësi pagimi. Për më tepër, edhe nëse do të kryhej përlllogaritja si në Komision, duke u kufizuar tek të ardhurat e tre muajve të parë të vitit, nga lëvizjet bankare në tri muajt e parë të vitit 2009 rezulton të jenë likuiduar tri fatura, vlera e të cilave është e barabartë me pagesën e kështit të parë. Duke mos marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara nga viti paraardhës, Komisioni e ka penalizuar.

9.29. Për sa më sipër, në linjë me vendime të mëparshme, trupi gjykues i Kolegjit thekson rëndësinë që kanë deklaratat periodike vjetore për sa i përket sidomos kursimeve në likuiditete jashtë sistemit bankar, në funksion të kontrollit të pasurive dhe kursimeve të deklaruara në deklaratën *vetting*. Konkluzioni i Komisionit, që i ka dhënë peshë këtij aspekti të deklarimit, është i bazuar në ligj dhe në jurisprudencën e Kolegjit³⁴.

9.30. Nga ana tjetër, pavarësisht nga pasaktësitë e treguara nga subjekti për gjendjen e *cash*-it në dy vitet, 2008 dhe 2009, dhe mosidentifikimi i burimit financiar, që ka shërbyer për të shlyer kështet apartamentit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi që do të ishte joproporcionale dhe binte ndesh me qëllimin e procesit të rivlerësimit, që në analizën e rrethanave të mos mbante në konsideratë aspekte kyçe të situatës jetësore të subjektit apo faktin që të ardhurat e konfirmuara e të dokumentuara të ligjshme, të krijuara nga bashkëshorti i subjektit, janë gjeneruar në një kohë që përkon me vitet kur janë shlyer pagesat e kryer pasuritë. Konkretisht, në këtë panoramë aspektesh, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë, së pari, që personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, i cili edhe ka gjeneruar të ardhurat me të cilat është krijuar pasuria objekt analize, ka ndërruar jetë disa vite përpara se subjekti të plotësonte deklaratën *vetting*. Së dyti, vitet në të cilat janë krijuar të ardhurat, me të cilat subjekti deklaroi edhe financimin e apartamentit, përkojnë me një periudhë kohore, gjatë së cilës bashkëshorti i ndjerë i subjektit ka krijuar të ardhura të ligjshme të konsiderueshme të dokumentuara, të cilat mundësonin edhe shlyerjen e kësteve të pagesave. Për shkak të këtyre të ardhurave, edhe në një qasje konservative, në të cilën të ardhurat përlllogariten në mënyrë përpjesëtimore, nga lëvizjet bankare do të rezultonte mundësi për të financuar kështet e analizuara.

9.31. Për një analizë shteruese dhe rigoroze, në Kolegj u krye analiza edhe bazuar në gjendjet e llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit në fund të vitit (2008 – 2009) dhe të ardhurave të tatuara, duke mbajtur në konsideratë: (i) mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë; (ii) deklarimin e subjektit gjatë hetimit administrativ, se për shlyerjen e kësteve shërbyen si burim të ardhurat e bashkëshortit gjatë vitit të mëparshëm; (iii) mosdeklarimin e gjendjes *cash* në banesë, nga viti në vit; (iv) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të konfirmuara nga DRT Shkodër, si dhe (v) faktit që për këtë periudhë nuk u evidentuan shpenzime të tjera.

9.32. Duke marrë shkas nga shpjegimet e subjektit për porositjen e apartamentit, që në tetor të vitit 2008, kur bashkëshorti i saj u dakordësua për çmimin dhe për mënyrën e shlyerjes së kësteve me

³⁴ *Arsyetuar, ndër të tjera, në vendimin e Kolegjit nr. 27/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Peka (paragrafi 19.4.v); dhe vendimin e Kolegjit nr. 4/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj (paragrafi 64.2).*

investitorin dhe faktin që, në periudhën janar – mars 2009, ai ka gjeneruar dhe tërhequr nga llogaritë bankare vlera të konsiderueshme, të përafërta me vlerën e kështit të shlyer, trupi gjykues ia nënshtrroi analizës edhe këto akte, për efekt të verifikimit të pretendimeve të subjektit për të mbajtur në konsideratë edhe sa rezultojn nga derdhjet në emër të personit fizik, për efekt të aktivitetit të personit fizik.³⁵ Nga verifikimi rezultoi se gjendja në fund të vitit ka qenë zero (ose në vlera të papërfillshme).

9.33. Për shlyerjen e kështit të parë, gjatë periudhës, nga data 05.01.2009 – 31.03.2009, janë depozituar shuma³⁶ në vlerën në total 12.658 euro, e cila e konvertuar me kursin e këmbimit të ditës së transaksioneve, do të ishte ekuivalenti i vlerës prej 1.589.266 lekë. Kësti i paguar në datën 29.03.2009 ishte 2.180.000 lekë. Kjo situatë financiare do të përfizonte një balancë negative prej (-) 590.734 lekësh për pagesën e kryer. Në të njëjtën linjë, për shlyerjen e kështit të dytë, në datën 29.03.2010, trupi gjykues i Kolegjit vëren se bashkëshorti i subjektit ka pasur një transferim në hyrje në llogarinë bankare, në vlerën 21.000 euro (nga “{***}” ShPK), nga e cila ai ka tërhequr vlerën prej 13.861 eurosh ose 1.925.293 lekë, tri ditë para datës së shlyerjes së kështit. Duke përfshirë këtë vlerë në mesin e burimeve të disponuara nga subjekti e bashkëshorti, në kohën kur është shlyer kësti i dytë, balanca negative e burimeve të ligjshme do të ishte në një vlerë relativisht të ulët, prej (-) 74.707 lekësh.

9.34. Nga kjo qasje, që përbën një variant konservator të përlllogaritjes së të ardhurave të disponuara të ligjshme, të bashkëshortit të subjektit, pa marrë në konsideratë të ardhurat e gjeneruara në vitin pararendës, subjekti do të rezultonte me një mungesë të burimeve të ligjshme, në total prej (-) 665.441 lekësh, për krijimin e pasurisë. Për rrjedhojë, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, përjashtimi i këtyre shumave nga analiza financiare do të rëndonte padrejtësisht pozitive të subjektit. Parë edhe nën dritën e lëvizjeve të tjera bankare të bashkëshortit të subjektit, gjatë kohës në fjalë, nga të cilat rezultojnë depozita dhe pagesa që përkojnë me natyrën e shërbimit, vlerën e projekteve dhe marrëveshjet e palëve, këto aspekte e bëjnë të besueshëm pretendimin e subjektit, se qasja përpjesëtimore nuk gjen zbatim, pasi të ardhurat nuk kanë qenë konstante gjatë vitit.

9.35. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pabazuar analizën e Komisionit dhe vlerësoi se këto të ardhura, duke u konfirmuar edhe vlera e tatuar për vitin 2010, e kalojnë testin e ligjshmërisë në zbatim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, pasi konfirmohet shlyerja e detyrimit nga administrata tatimore dhe duhet të ishin pjesë e analizës financiare. Duke theksuar se të ardhurat janë të ligjshme, disponohen në një kohë të shkurtër nga data 31 dhjetor e vitit pararendës, nuk vërehen shpenzime të tjera dhe subjekti rezultojn me balancë pozitive vjetore³⁷, trupi gjykues, për gjithë sa më sipër, vlerësoi t’i përfshirë

³⁵ Për shembull: Në datën 01.07.2009, është kryer një pagesë që e pretendon subjekti, në llogarinë personale të bashkëshortit, me përshkrim: “Transferte e Brendshme S. B. KEMBIM LEK/EUR ME KURS 131.8 PER PAGESEN E A. D. SUPERVIZORI M. SH., MARS, PRILL, MAJ, QERSHOR 2009 – vlera 9.230 euro”.

³⁶ Transfertat e dokumentuara janë si vijon: në hyrje nga “{***}”, me përshkrimin “likuidim fature nr. {***}, datë 23.12.08”, në vlerën 1.189 euro/146.901 lekë, në datën 05.01.2009. Kjo vlerë është tërhequr nga personi i lidhur brenda ditës; transfertë në hyrje nga “{***}” ShPK, në vlerën 1.969 euro/246.125 lekë, në datën 21.01.2009. Në datë 23.01.2009, z. A. D. ka tërhequr vlerën 2.000 euro; dhe transfertë në hyrje nga “{***}” ShPK, në vlerën 9.500 euro/1.196.240 lekë, në datën 02.02.2009. Kjo vlerë është tërhequr brenda ditës.

³⁷https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/07/Vendim-i-anonimizuar-JR-Mariana-Shegani_p%C3%ABrfshir%C3%AB-mendimet-e-pakic%C3%ABs_word-1.pdf.

të ardhurat e disponuara në fund të vitit në vlerat e konfirmuara nga administrata tatimore, të cilat kanë qenë në total rreth 8.1 milionë lekë në vitet 2008 – 2011.³⁸

9.36. Në këtë këndvështrim, edhe faturat tatimore dhe blloku i shitjeve që ka sjellë subjekti në Kolegj, duke abstraguuar nga vlerësimi për mospërmbushje të kriterëve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, si provë e re, sugjerojnë ekzistencën e të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit në një periudhë kohore shumë të afërt me pagesat e kësteve të apartamentit. Në këtë rast, trupi gjykues iu referua elementeve që vijojnë: (i) të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti i arkitektit është i vetmi burim i deklaruar nga subjekti për krijim e pasurisë objekt analize; (ii) gjatë periudhës 2008 deri në mars të vitit 2009 (kur u shlye kësti i parë, por situata paraqitet e njëjtë edhe për këstin e dytë) nuk konstatohen shpenzime të tjera; (iii) të ardhurat e bashkëshortit, për vitin 2008, janë të ardhura të tatuara dhe në një vlerë fitimi prej 4.164.065 lekësh, të cilat janë disponuar në të njëjtën kohë me pagesën e këstit të parë të apartamentit³⁹; (iv) vlera e të ardhurave të këtij viti, jo vetëm e mbulon këstin e parë, por është afërsisht sa vlera totale për dy këstet të apartamentit të paguara në periudhën 2009 – 2010, që është 4.180.000 lekë (*pa përfshirë 500.000 lekë, që u paracaktua se do të shlyhej me regjistrimin e pasurisë*) dhe (v) ndër vite, subjekti nuk deklaroi kursime jashtë sistemit bankar, si një mënyrë sjelljeje e jo vetëm për këtë pasuri.

9.37. Për sa më lart, trupi gjykues i çmoi pa relevancë, në drejtim të zgjidhjes së çështjes, pretendimet për mënyrën se si duhet të deklarohet gjendja e arkës së personit fizik, në kushtet që ka dokumentacion zyrtar, që provon krijimin e tyre dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në kushtet jetësore që rezultojnë kundrejt mundësisë së sigurimit të dokumentacionit dhe që pagesat janë kryer pak ditë përpara deklaratave periodike vjetore përkatëse (në datën 31.03.2009 dhe 30.03.2010), dhe para pagesave të tatimeve sipas konfirmimit të DRT-së Shkodër, deklarimi i subjektit se, për shkak të padijenisë, nuk mund të deklaronte në deklaratën periodike vlerën e fitimit, meqenëse iu nënshtrua tatimit një - dy ditë para dorëzimit, duket i besueshëm se pasqyron një qasje të saj të bazuar në kronologjinë e hapave të ndjekur.

9.38. Përpos sa më sipër dhe duke abstraguuar nga besueshmëria e shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegji vëren se analiza e Komisionit për të përlllogaritur të ardhurat e bashkëshortit të subjektit në mënyrë proporcionale vjetore, është e pasaktë dhe e pazbatueshme për natyrën e aktivitetit. Konkretisht, edhe në alternativën e situatës ligjore të konstatuar nga Komisioni, sipas së cilës pretendimet e subjektit nuk u vlerësuan bindëse, dhe të ardhurat e viteve pararendëse të momentit kur janë shlyer dy këstet e apartamentit nuk do të përfshiheshin në analizë, nga dokumentacioni i përcjellë nga institucionet financiare, Kolegji konstatoi mungesën e burimeve për likuidimin e këstit të parë, në vlerën prej (-) 590.734 lekësh dhe (-) 74.707 lekësh, për këstin e dytë. Këto vlera përftohen vetëm duke përfshirë të ardhurat e transferuara nëpërmjet sistemit bankar për kryerjen e shërbimeve nga personi i lidhur/bashkëshorti, si person fizik, për periudhat janar – mars të viteve 2009 dhe 2010. Me fjalë të tjera, edhe parë nën këtë dritë, mungesa e burimeve në vlerën (-) 665.441 lekë, për krijimin e pasurisë në fjalë, nuk mund të vlerësohet në drejtim të marrjes së masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra

³⁸ Sipas dokumentacionit të përcjellë Komisionit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, fitimi neto i realizuar dhe i disponuar, pas pagesës së detyrimeve tatimore nga bashkëshorti i subjektit, ka qenë: 4.164.065 lekë për vitin 2008, 2.645.329 lekë për vitin 2009, 805.309 lekë për vitin 2010 dhe 1.156.551 lekë për vitin 2011.

³⁹ Shkresa e tatimeve referon që datat e pagesave janë 31 mars 2009 dhe 30 mars 2010.

9.39. Në përmbledhje të sa më sipër, për apartamentin në Shkodër, objekt analize, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke mos specifikuar burimin e krijimit të apartamentit objekt analize, duke u gjendur kështu në një lexim *a contrario* të gremës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, duke pranuar shpjegimet e subjektit, rezulton se ajo dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për pagesën e të dyja kësteve sipas mënyrës dhe në momentin e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, duke përmbushur kushtet e përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

10. *Për automjetin “Volkswagen Golf”, të blerë në vitin 2007, me vlerë 250.000 lekë*

10.1. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* krijimin e kësaj pasurie, sipas kontratës së shitblerjes së datës 23.03.2007, dhe pagesën e kryer prej 250.000 lekësh dhe vlerën e doganës 145.072 lekë. Subjekti nuk e ka identifikuar burimin. E njëjta situatë rezulton edhe nga deklarata periodike për vitin 2007. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën *vetting*, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë objekt ankimi, në kundërshtim me parashikimet e gremës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, dhe që ajo dhe personi i lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve, për shkak të një balance negative prej (-) 590.589 lekësh, në datën 23.03.2007, duke u gjendur në kushtet e gremës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, Komisioni nuk e konsideroi bindës deklarimin e subjektit, se bashkëshorti mori hua nga vëllai i saj për blerjen e kësaj pasurie.

10.2. Subjekti pretendon në ankim se si burim i krijimit të saj ka shërbyer depozita e vitit 2006, e bashkëshortit, në Tirana Bank. Huaja iu mor vëllait, për të mos humbur interesat nga depozita me afat dhe u kthye brenda vitit. Subjekti pretendon se i vëllai ka pasur mundësi për dhënien e huas dhe paraqiti në Komision, por edhe bashkëlidhur ankimit në Kolegj, akte për të provuar të ardhurat e tij në Itali. Sa i takon mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurisë në deklaratën periodike, subjekti pretendon se gabimet e paqëllimshme në deklaratat periodike nuk mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi në kuadër të procesit të rivlerësimit.

10.3. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse Komisioni, konstaton se subjekti është në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën *vetting*, për shkak se nuk ka specifikuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me përcaktimin e gremës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Pasi analizoi pretendimet e subjektit në ankim dhe kontrolloi analizën financiare të Komisionit, trupi gjykues konfirmon konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas gremës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, në kushtet që tërheqja e depozitës ka ndodhur pasi është kryer blerja. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, pasi trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi aktet në fashikull dhe shqyrtoi pretendimet e subjektit në ankim, rezultoi një balancë negative totale për të gjithë përdhën e rivlerësimit, në vlerën (-) 832.454 lekë, që përbëhet nga balanca negative e konstatuar për blerjen e automjetit “Volkswagen Golf”, në vlerën (-) 590.588 lekë, në datën 23.03.2007, dhe balanca negative në vlerën (-) 241.866 lekë, për vitin 2016. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

10.4. Nga kontrolli i fashikujve të krijuar në Komision rezulton se, për herë të parë, burimi i krijimit të pasurisë për blerjen e automjetit u deklarua në përgjigje të pyetësorit nr. 1, kur subjekti e pyeti Komisioni në mënyrë specifike. Në atë moment dhe gjatë shpjegimeve në kuadër të përmbushjes së barrës së provës dhe në seancën dëgjimore, duke potencuar se nuk ishte në dijeni më parë, subjekti pretendoi se burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë objekt analize, ishte një depozitë me afat në Tirana Bank, e krijuar në vitin 2006, e cila u tërhoq tre muaj pas lidhjes së kontratës, për blerjen e automjetit. Subjekti shpjegoi se, për të shmangur humbjen e interesave nga depozita me afat njëvjeçar, bashkëshorti i saj u ndihmua nga vëllai i subjektit, i cili i ofroi ndihmën financiare për një periudhë të shkurtër, prej tre muajsh. Pas mbushjes së afatit, depozita u tërhoq dhe shuma u përdor për shlyerjen e huas.

10.5. Komisioni nuk i pranoi aktet e sjella nga subjekti gjatë hetimit administrativ për të provuar mundësinë financiare të vëllait për huadhënien, përfshirë edhe një deklaratë noteriale të tij, të datës 27.10.2021, nëpërmjet së cilës konfirmon se i huazoi bashkëshortit të subjektit vlerën 395.000 lekë, për blerjen e automjetit. Komisioni vlerësoi se ekzistenca e marrëdhënies së huas, nuk gjen pasqyrim në akte në kohën e krijimit të saj.

10.6. Trupi gjykues i Kolegjit, në linjë me qëndrimin e Komisionit, vlerësoi se aktet e sjella me ankimin për të provuar mundësinë financiare të vëllait të subjektit, referuar më sipër, nuk e kalojnë testin e përcaktuar nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për të marrë cilësinë e provave të reja në ankim. Si të tilla nuk iu nënshtruan kontrollit. Për më tepër, deklarata e vëllait të subjektit, e paraqitur në kuadër të procesit të rivlerësimit, nuk mbështetet me akte të tjera, që të provojë ekzistencën e marrëdhënies së huas. Në zbatim të pikës 15⁴⁰ të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095/2016, në rast të deklarimit të huamarrjes në likuiditete, deklarimi duhet të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit, referuar edhe praktikës së Kolegjit, deklarata, për efekt të procesit të rivlerësimit, ka fuqi të kufizuar provuese të faktit të pretenduar. Në kushtet që në asnjë moment përpara hetimit administrativ, subjekti nuk ka specifikuar të dhëna në lidhje me burimin apo ekzistencën e marrëdhënies së huas, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se deklarimi i subjektit në deklaratën *vetting* është i pasaktë dhe vjen në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10.7. Pretendimi i subjektit, se gabimet e paqëllimshme në deklaratat periodike nuk mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi në kuadër të procesit të rivlerësimit, është i pabazuar, në kushtet që Komisioni nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi në kuadër të procesit të rivlerësimit për pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike, por pasaktësitë e subjektit lidhen me deklaratën *vetting*, e cila është objekt i kontrollit të organeve të rivlerësimit. Në kushtet që subjekti ishte në gjendje të parashtronte burime krijimi në hetimin administrativ, argumentimi për mungesë të dijenisë, në kohën kur ajo ka hartuar deklaratën *vetting*, vlerësohet shpjegim jobindës. Për rrjedhojë, ky konstatim i Komisionit është i bazuar.

10.8. Edhe analiza e kryer nga Komisioni, për mundësinë e krijimit të pasurisë është e saktë. Subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Paga e subjektit është kredituar në llogarinë bankare çdo muaj. Megjithatë, gjatë periudhës

⁴⁰ Deklarimi i huamarrjeve dhe i huadhënieve në likuiditete, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor dhe me vërtetimet bankare, në rast se veprimi në kohën e kryerjes së tij është kryer me transaksion bankar.

01.01.2007, deri në momentin e blerjes së automjetit, në datën 23.03.2007, rezulton të jenë tërhequr nga llogaria vetëm 50.000 lekë. Ndërsa për këtë periudhë, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit nuk ka ndonjë transaksion bankar dhe gjendja e kësaj llogarie, në datën 31.12.2006, është 9.650 lekë, e tërhequr në prill të vitit 2007. Për rrjedhojë, ashtu si dhe Komisioni, në kontrollin e analizës së ushtruar në Kolegj, si të ardhura që mund të kenë shërbyer për blerjen e automjetit dhe mbulimin e shpenzimeve, u konsideruan vetëm shumat e tërhequra nga llogaria e subjektit, nga ku u konfirmua gjendja e mungesës së burimeve të ligjshme për shlyerjen e vlerës sa ajo e Komisionit, (-) 590.588 lekë (vlera e automjetit bashkë me shpenzimet e jetesës). Vlen të theksohet fakti se, përveç depozitës në shumën 650.668 lekë, rezulton se subjekti ka pasur në gjendje në llogarinë rrjedhëse shumën 426.575 lekë, e cila është krijuar nga kreditimet e pagës dhe nuk ka qenë e investuar në depozitë, që të mund të humbiste interesat bankarë. Kjo shumë nuk është tërhequr nga llogaria në momentin e blerjes së automjetit, pavarësisht se ishte e mjaftueshme për të mbuluar gjithë çmimin.

10.9. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse Komisioni, konstaton se subjekti është në kushtet e deklaratimit të pasaktë në deklaratën *vetting*, pasi nuk ka specifikuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me përcaktimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Pasi analizoi pretendimet e subjektit në ankim dhe kontrolloi analizën financiare të Komisionit, trupi gjykues konfirmon konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, në kushtet që tërheqja e depozitës ka ndodhur pasi është kryer blerja.

11. *Për analizën financiare*

(i) Shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortit në Turqi, në vitin 2010

11.1. Subjekti pretendon në ankim se Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë deklaratën e z. Xh. B., i cili konfirmon se shpenzimet e bashkëshortit të saj janë përballuar prej tij, sepse kishin marrëdhënie pune, për shkak të të cilave u krye edhe udhëtimi. Në kushtet kur Komisioni nuk mori në konsideratë deklaratën noteriale, subjekti shpjegon se iu drejtua Bashkisë Shkodër, për të marrë projektin e bashkëshortit të saj, të punuar për interesat e z. B. (për shoqërinë “{***}” ShPK). Së bashku me këtë shkresë, subjekti paraqiti në ankim lejen e ndërtimit, vendimin e KRrT-së, të datës 28.12.2009, dhe projektin e miratuar nga KRrT-ja, për ndërtimin e një kompleksi banimi, 7 kate + 2 kate dyqane + bodrum, të punuar nga ark. A. D. dhe porositës z. Xh. B. Subjekti pretendon se ky fakt konfirmon deklaratën noteriale të z. Xh. B., sipas të cilës udhëtimi është realizuar për këtë projekt dhe shpenzimet janë paguar nga ai, të cilat duhet të përlllogariten në vlerën 5 euro/dita, sipas praktikës së Kolegjit.

11.2. Për shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortit të subjektit në Turqi, në vitin 2010, në periudhën 18.11.2010 – 21.11.2010, Komisioni arriti në përfundimin se shpjegimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ, pasi nuk arriti të provonte marrëdhënien e bashkëpunimit të personit të lidhur me z. Xh. B. Në këto kushte, Komisioni ka përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit në vlerën 50 euro/dita.

11.3. Sikurse arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në ankim nuk i plotëson kriteret e provës së re, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012,

pasi subjekti nuk ka paraqitur pengesat që pamundësuan paraqitjen në Komision, dhe si i tillë nuk iu nënshtrua shqyrtimit.

11.4. Nga praktika e Kolegjit, shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur në vlerën 5 euro/dita, në rastet kur nga subjekti i rivlerësimit provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë. Në këtë rast, atij/atyre do t'u llogariten vetëm sasia e të hollave të xhepit, prej 5 eurosh/dollarësh amerikanë në ditë⁴¹. Për të provuar mbulimin e shpenzimeve nga personat e tretë, konkretisht nga z. Xh. B., subjekti ka dorëzuar deklaratën e këtij të fundit në Komision, i cili konfirmon se, gjatë periudhës 18 – 21 nëntor 2010, ka udhëtuar në Turqi, së bashku me z. A. D., për zgjedhjen e materialeve të ndërtimit për banesën e tij, dhe se të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit janë mbuluar nga ai.

11.5. Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson se shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortit të subjektit, për tri ditë, janë përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 330 euro në total. Vlerë, e cila nuk ka ndikim në balancën negative të konstatuar për vitin 2010. Në të njëjtën kohë, ky udhëtim është kryer pas shlyerjes së kështit të dytë të apartamentit, në mars 2010, dhe nuk ndikon në krijimin e pasurisë. Në çdo rast, edhe nëse këto shpenzime përlllogariten sipas pretendimit të subjektit, duke konsideruar vetëm shpenzimin prej 5 euro në ditë, balanca për vitin 2010 mbetet negative.

(ii) Për mosdeklarimin e gjendjes së llogarisë në Tirana Bank

11.6. Komisioni ka konstatuar mosdeklarim të gjendjes së likuiditeteve në llogarinë bankare të pagës së subjektit, në vlerën 589.586 lekë, dhe konkludoi që subjekti është në kundërshtim me kërkesën e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, që u vlerësua përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

11.7. Subjekti kundërshton sa më sipër, duke u shprehur se mosdeklarimi ka ndodhur për shkak të lodhjes dhe ngarkesës në punë. Ajo potencon edhe që ka deklaruar të ardhurat nga paga, e në mënyrë indirekte, edhe këtë llogari.

11.8. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se konstatimi i Komisionit për pasaktësinë sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar. Nga ana tjetër, në kushtet që është fjala për llogarinë e pagës së subjektit dhe të ardhurat janë deklaruar në deklaratën *vetting*, mosdeklarimi u vlerësua si një pasaktësi, pa peshë e ndikim në vlerësimin tërësor të subjektit.

11.9. *Për mungesën e burimeve prej 252.031 lekësh, në vitin 2016*

11.9/a. Pas kryerjes së analizës financiare, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 252.031 lekë, në vitin 2016, për kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

11.9/b. Subjekti pretendon në ankim, se kjo balancë vjen për shkak se fëmijët morën një suport ekonomik modest nga gjyshërit, për përbalimin e shpenzimeve të jetesës, që justifikon edhe mungesën e konstatuar. Sidoqoftë, subjekti kërkon nga Kolegji që analiza të kryhet duke zbatuar parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit. Subjekti pretendon se nuk gjendet në kushtet e

⁴¹ Shih vendimin Kolegjit nr. 11/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj.

mungesës së burimeve; nuk ka bërë deklaram të rremë; nuk ka bërë fshehje pasurie; si dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, ndaj masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në rastin e saj nuk gjen zbatim.

11.9/c. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi i subjektit, se fëmijët janë ndihmuar nga gjyshërit, nuk u deklarua as në deklaratën periodike për vitin 2016, e as në atë të *vetting*. Po ashtu, ky fakt nuk është dokumentuar në asnjë mënyrë. Për rrjedhojë, ky pretendim mbetet i paprovuar/deklarativ.

11.9/ç. Për sa i përket rezultatit për vitin 2016, subjekti në ankim pohon se ka një rezultat negativ, në shumën (-) 234.843 lekë, me një diferencë prej 17.188 lekësh, por nuk kundërshton ndonjë element specifik të analizës së kryer nga Komisioni.

11.9/d. Në parashtrimet në Komision, subjekti paraqiti një analizë të përgatitur nga audituesi ligjor për gjithë periudhën e rivlerësimit, ku në vitin 2016 konstatohet se shpenzimet e udhëtimit, krahasuar me ato të përlllogaritura nga Komisioni, janë më të ulëta, për një diferencë prej 16.232 lekësh. Megjithatë, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë pretendim konkret për këtë diferencë, përveç faktit se fëmijët u ndihmuar nga gjyshërit.

11.9/dh. Nga kontrolli i analizës së kryer prej Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, për shpenzimet e gjithë periudhës së analizuar, rezulton se Komisioni ka konvertuar shpenzimet e udhëtimit nga euro në lekë, duke përdorur kursin mesatar të këmbimit të muajit dhjetor të çdo viti. Sipas jurisprudencës së Kolegjit, vlerat duhet të konvertohen në lekë duke përdorur kursin mesatar vjetor të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë, përveç rasteve kur kursi i këmbimit është përcaktuar qartë në aktet shkresore justifikuese të transaksionit përkatës, ose kur data e transaksionit është e provuar me akt shkresor. Në rastet kur data e transaksionit është e qartë, si në rastin konkret, atëherë nga Komisioni duhet të ishte aplikuar kursi i këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, sipas të njëjtit burim zyrtar. Nga aplikimi në Kolegj i kursit mesatar vjetor të konvertimit të të ardhurave nga euro në lekë, balancat negative të rezultuara nga Komisioni përmirësohen me një vlerë prej 82.370 lekësh, për gjithë periudhën e analizuar, duke zbritur kështu nga (-) 252.031 lekë, në (-) 241.866 lekë.

12. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit në Kolegj me korrektimet përkatëse, rezultoi një balancë negative totale për të gjithë periudhën e rivlerësimit, në vlerën (-) 832.454 lekë, që përbëhet nga balanca negative e konstatuar për blerjen e automjetit “Volkswagen Golf”, në vlerën (-) 590.588 lekë, në datën 23.03.2007, dhe balanca negative në vlerën (-) 241.866 lekë, për vitin 2016. Në këto kushte, balanca negative e përfutur është e pamjaftueshme dhe do të ishte joproporcionale dhe jo e drejtë për të passjellë masën disiplinore të shkarkimit, nën dritën e parimit të *proporcionalitetit*.
13. Pretendimet e subjektit që lidhen me aspektet të vlerësimit të aftësive profesionale, në kushtet kur Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit është “e aftë”, nuk u vlerësuan me relevancë për t’u trajtuar në drejtim të zgjidhjes së çështjes.
14. Për sa më lart, balanca negative që rezultoi, së bashku me pasaktësinë nëpërmjet ometimit të burimeve konkrete të krijimit të pasurive në deklaratën *vetting*, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit është e pamjaftueshme që të passjellë shkarkimin e subjektit të rivlerësimit e

disproporcionale në rrethanat faktike e ligjore konkrete. Për këto arsye, duke mbajtur në konsideratë vlerësimin pozitiv të Komisionit për dy kriteret e tjera, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm edhe në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 496, datë 12.01.2021, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, është i pambështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 496, datë 12.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ermira Dedja.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 25.03.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi